



Prishtinë, 28 janar 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_774\_2016

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, Nenit 25, Nenit 29 dhe Nenit 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 6 dhe Nenit 18 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë; dhe
- Aplikacionin për licencim të aktivitetit të importit, eksportit dhe transitit të energjisë elektrike të dorëzuar në ZRRE me datë 19.11.2015 nga ndërmarrja "AXPO KOSOVO" L.L.C., adresa: Pashko Vasa Nr.18, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

**Në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2016, nxori këtë:**

## VENDIM

- I. I **LËSHOHET** Licenca për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike ndërmarrjes "AXPO KOSOVO" L.L.C., me numër licence ZRRE/Li\_46/15 për periudhën nga data **28 janar 2016** deri **27 janar 2021**.

## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 19.11.2015 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike nga ndërmarrja "AXPO KOSOVO" L.L.C.
  - ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave/dëshmive të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike.
  - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmive të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Licenca për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet deri **100 MW**, në pajtim me Licencën dhe legjisllacionin tjetër në fuqi.


- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:


- Të licencuarit "AXPO KOSOVO" L.L.C.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar

  
Arsim Janova, anëtar

  
Qemajl Mustafa, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar